



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:164109
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05375682

KPPP.nr.1169/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit D.P.T “ADIS-B”, me seli në Mamushë, me NUI: 810987828, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.A. avokat nga Prizreni, kundër debitorit “MELODIA PROJEKT” Sh.P.K., me seli në rr. “Ibrahim Rugova” Davidoc, Komuna e Shtimes, me NUI: 811023936, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.205/2023 të datës 03.07.2023 të lejuar nga Përbaruesi Privat Enis Hoxha, me seli në Prizren, jashtë seancës me datën 02.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET SI I PA AFAT prapësimi i debitorit “MELODIA PROJEKT” Sh.P.K., ndërsa Urdhri P.nr.205/2023 i datës 03.07.2023, i nxjerrë nga Përbaruesi Privat Enis Hoxha MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit D.P.T “ADIS-B”, ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr.205/2023 të datës 03.07.2023, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës nr.2 të datës 15.03.2023, duke detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga fatura, nga dita e pranimit të këtij urdhri të

paguaj detyrimin në shumë prej 1,765.00 Euro, në emër të borxhit kryesor, me kamatë vjetore 8% nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbarrim, si dhe të gjitha shpenzimet procedurale nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Debitori ka paraqitur prapësim ndaj urdhrin përmbarrimor të lartcekur.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të gjykatës, debitori Urdhrin Përmbarrimor P.nr.205/2023 të datës 03.07.2023, të lejuar nga Përmbarruesi Privat Enis Hoxha, e ka pranuar me datë 07.07.2023, e cila vërtetohet nga fletëkthesa e Përmbarruesit Privat që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është dorëzuar me datën 19.07.2023, e cila vërtetohet nga vula e pranimit të Përmbarruesit Privat që gjendet në shkresat e lëndës.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarrues ose urdhrin përmbarrues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se *“Në qoftë se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme”*.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori Urdhrin Përmbarrimor P.nr.205/2023 të datës 03.07.2023, e ka pranuar me datën 07.07.2023, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimimit ka filluar të rrjedhë nga data 08.07.2023, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimimit ka qenë data 14.07.2023, por debitori prapësimin e ka dorëzuar tek Përmbarruesi Privat me datën 19.07.2023, dhe nga kjo rezulton se prapësimi është dorëzuar 5 (pesë) ditë me vonesë.

Rrjedhimisht, meqenëse është konstatuar pasafatshmëria, gjykata nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve të tjera të parashtruara nga debitori dhe në bazë të nenit 73 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1169/23, me datë 02.02.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.